



Joint German-Danish “Support to Agriculture and Rural Economic Development of Disadvantaged Mountainous Areas” (SARED)

## Raportimi tek GIZ-SARED / AAM Aktivitetet e Grupeve të Zinxhirit të Vlerës datë 24 - 25 Prill 2017:

Rritja e të ardhurave për prodhuesit dhe grumbulluesit e Bimëve Aromatike dhe Medicinale (BAM) në Shkodër (2 grupe, në Tamarë dhe Shkrel)

OJF Zbatuese: Shoqata Shqiptare e Marketingut (ShShM)

Region and date	vc	NGO / association	Initiative /Component	No. of VC-groups	location	name of facilitator / expert	name of liaison - extension officer(s)
Shkodër 24 Prill 2017	MAP	AAM c: Besart Pudja p: +355 66 55 39 269 e: a.pudja@aam.al c: Keti Luli p: +355 69 22 68 879 e: info@aam.al	Zhvillimi i sesionit të trajnimit të grupit të grave në zonën e Vrithit lidhur me: “Menaxhimi i biznesit dhe administrimi i fermës, plani financiar”.	1	Vrith / Shkrel,  Shkoder	Besard Pudja / Altina Peshkatarri	DoA, Shkoder – Xheladin Zekaj
Shkodër 25 Prill 2017	MAP	AAM c: Besart Pudja p: +355 66 55 39 269 e: a.pudja@aam.al c: Keti Luli p: +355 69 22 68 879 e: info@aam.al	Zhvillimi i sesionit të trajnimit të grupit të grave në zonën e Tamarës lidhur me: “Menaxhimi i biznesit dhe administrimi i fermës, plani financiar”.	1	Tamara  Shkoder	Besard Pudja / Altina Peshkatarri	

**24 Prill 2017 – Zhvillimi i sesionit të trajnimit të grupit të grave në zonën e Vrithit lidhur me: “Menaxhimi i biznesit dhe administrimi i fermës, plani financiar”.**

*Ekspert: Altina Peshkatarri, Ekstensionist pranë Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër: z. Xheladin Zekaj, datë 24 Prill 2017, fshati Vrith, Njësia Administrative Shkrel, Shkodër.*

Në trajnim me temë “Menaxhimi i biznesit dhe administrimi i fermës, plani financiar” morën pjesë 14 gra anëtare të grupit të zinxhirit të vlerës në zonën e Vrithit. Qëllimi i këtij trajnimi ishte rritja e njohurive dhe kapacitetit të grupit të zinxhirit të vlerës lidhur me fushat kryesore të menaxhimit të biznesit, marrjen e vendimeve të duhura të orientuara nga kërkesat dhe nevojat e tregut, hartimi dhe zbatimi i planit të biznesit duke përfshirë dhe planin financiar, etj. Diskutimet aktive lidhur me hapat e nevojshme dhe çelësin e suksesit për një menaxhimin efektiv të biznesit, si dhe puna në grup në përgatitjen e analizës SWAT për produktet e grupit nxorrën në pah vështirësitë e grupit të grave si: mungesë investimesh në kapacitete logjistike, paketim, etiketim, pjesëmarrje në panairë, promovim, mungesë mbështetjeje në marrëdhënie me institucione lokale dhe qendrore, etj, për të cilat kërkuan dhe mbështetjen suportin tonë. Gjithashtu gjatë kësaj teme trajnimi grupi i grave identifikoi vlerat e shtuara për produktet, si: rritje të cilësisë së

**Joint German-Danish “Support to Agriculture and Rural Economic Development of Disadvantaged Mountainous Areas” (SARED)**

produkteve lokale, rritje të ofertës për produktet lokale, zgjerim të portofolit të produkteve, penetrim në tregje premium, promovim i zonës dhe grupit të grave, etj.

Trainimi u mundësua me mbështetjen e projektit SARED, bashkëfinancuar nga qeveritë e Danimarkës dhe Gjermanisë dhe që zbatohet në Shqipëri nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ). Nëpërmjet projektit SARED, GIZ mbështet me granted dhe rritje kapacitetesh fermerë të zonave rurale me qëllim rritjen e prodhueshmërisë dhe cilësisë, si dhe lehtësimin e aksesit në tregje.



**25 Prill 2017 – Zhvillimi i sesionit të trajnimit të grupit të grave në zonën e Tamarës lidhur me: “Menaxhimi i biznesit dhe administrimi i fermës, plani financiar”.**

*Expert: Altina Peshkatari, datë 25 Prill 2017, fshati Tamarë, Njësia Administrative Kelmend, Shkodër*

18 gra të grupit të zinxhirit të vlerës në zonën e Tamarës morën pjesë në sesionin e trajnimit me temë “Menaxhimi i biznesit dhe administrimi i fermës, plani financiar”. Kjo temë u vlerësua si mjaft e rëndësishme nga grupi i grave në rritjen e njohurive dhe kapaciteteve të tyre lidhur me hapat e nevojshme për një menaxhim efektiv dhe të suksesshëm të biznesit bujqësor dhe rëndësinë e hartimit të një plani të detajuar financiar. Trainimi u mundësua me mbështetjen e projektit SARED, bashkëfinancuar nga qeveritë e Danimarkës dhe Gjermanisë dhe që zbatohet në Shqipëri nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ). Nëpërmjet projektit SARED, GIZ mbështet me granted dhe rritje kapacitetesh fermerë të zonave rurale me qëllim rritjen e prodhueshmërisë dhe cilësisë, si dhe lehtësimin e aksesit në tregje.

Shembujt e marra gjatë trajnimit dhe analiza SWAT e zhvilluar për produktet e grupit nxitën një debat aktiv lidhur me vështirësitë dhe nevojat e grave të tilla si: mungesa e zhvillimit të konceptit marketing (paketim, etiketim) për produktet e tyre, mungesë investimesh në teknologji dhe mjete për përmirësim e cilësisë së produkteve lokale, vështirësi në arritje dhe penetrim të

**Joint German-Danish “Support to Agriculture and Rural Economic Development of Disadvantaged Mountainous Areas” (SARED)**

tregjeve, promovim, mungesë orientimi drejt institucioneve lokale dhe qendrore, etj. Gjithashtu, këto diskutime dhe njohuri të marra çuan në identifikimin e vlerave e shtuara për produktet e grupit të grave siç ishin: rritje të ofertës për produkte lokale cilësore, rritje të gamës së produkteve, rritje të çmimit për produktin final, zgjerim të kanaleve të shpërndarjes, promovim i zonës dhe grupit të grave.



\*\*\*